

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**, Departamenti për Çështje Administrative ,me gjyqtaren Anita Nikçi-Morina dhe me bashkëpunëtorin profesional Lirim Bektashi,në konfliktin administrativ të paditëses A.H. me vendbanim në P., Rr. "R.Xh." kundër të paditurës Qeveria e Kosovës - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë – Departamenti i Administratës Pensionale të Republikës së Kosovës, për shkak të anulimit të vendimittë Nr.600731 dt. 22.08.2017, në shqyrtimin kryesor publik, të mbajtur me dt. 16.10.2018, merr këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**I. AROVOHET** kërkesëpadia e paditëses A.H. me vendbanim në P..  
**ANULOHET** vendimi i Qeverisë së Kosovës - Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-DAPRK në Prishtinë, me numër të dosjes Nr.600731 dt. 22.08.2017dhe çështja i kthehet të paditurës në rishqyrtim dhe rivendosje.

### **A r s y e t i m i**

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike është mbajtur në kuptim të nenit 41 të Ligjit të Konfliktit Administrativ në mungesë të palës së paditur dhe përkundër dëshmisë/ftesës se pala e paditur është ftuar me rregull në seancën gjyqësore.

Paditësja, në seancën e shqyrtimit kryesor dhe me padinë ushtruar me dt. 10.10.2017, ka kërkuar nga gjykata që të anulohet vendimi i Qeverisë së Kosovës - Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-DAPRK-së në Prishtinë, me numër të dosjes 600731 dt. 22.08.2017dhe lënda të kthehet në rishqyrtim, me pretendim se vendimi i atakuar është marrë në kundërshtim me ligjin. Ka theksuar se paditësja është e paaftë për punë dhe këtë të drejtë e ka gëzuar rreth 4 viteve për shkak paaftësisë së plotë dhe të përhershme për punë, mirëpo me Vendimin e DAPK të datës 22.08.2017 pa bazë ligjore dhe në kundërshtim me provat e dorëzuara i është mohuar kjo e drejtë.

E paditura në përgjigje në padi me dt. 07.06.2018i ka propozuar gjykatës që ta refuzojë padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi me numër të dosjes 600731 dt. 22.08.2017 si vendim i ligjshëm, me pretendim se paditësja nuk i plotëson kushtet ligjore për njohjen e të drejtës së pensionit për persona me aftësi të kufizuar.

Gjykata në seancën e dt. 16.10.2018 ka bërë administrimin e provave dhe atë: Padia e dt. 10.10.2017, dokumente mjekësore dt.10.10.2017, vendimi i dt.02.10.2017, librezja për realizimin e te drejtës se pensionit, përgjigja ne padi e dt.07.06.2018, vlerësimi i komisionit mjekësorë dt.28.07.2017, vendimi i dt.05.03.2015, dokumente mjekësorë e dt.22.12.2016, Inqizimete dt.21.12.2016, vendimi i dt.14.04.2017,raporti i komisionit profesional, document mjekësor dt.16.03.2017, ankesa e dt.31.05.2017, vendimi i dt.02.03.2011, dokumente mjekësore.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor dhe gjeti se kërkesëpapia e paditësit është e bazuar .

Nga vendimi i kontestuar del se ai përmban të meta të tilla për shkak të të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 84 par.2 të këtij ligji është paraparë se akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimin e goditur me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti, etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar. Në nenin 85 të po të njëjtit ligji, parashihet se përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepet domosdoshmërisht arsyet për të gjitha atoakte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtën dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar, etj. Arsyetimet duhet të formulohen qartë dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit.

Vendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e vendimit është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se Këshilli i Ankesave me ekspert mjekësor të lēmive përkatëse, duke vepruar sipas ankesës së paditësit në mënyrë të gjithanshme, në seancën e vet të datës 22.08.2017, i ka shqyrtuar shkresat e lëndës, pretendimet ankimore, dokumentacionin mjekësor, që gjendet në lëndë dhe vlerësimin e Komisionit Mjekësor të shkallës së parë të dt. 28.03.2017 në përputhje me nenin 5 dhe nenin 9 të Ligjit PPAK, dhe ka konstatuar se nuk ka dëshmi të mjaftueshme për të qenë shfrytëzuese e pensionit me aftësi të kufizuara të plotë dhe të përhershme. Po ashtu në arsyetimin e këtij vendimi thuhet se Komisioni ekspertëve mjekësor kanë vlerësuar komplet dokumentacionin mjekësor dhe për bazë ka marrë certifikatën e mjekësisë familjare të licencuar, dokumentacionin mjekësor si dhe raportet nga specialistet dhe është konstatuar se nuk ka sjellë dëshmi të mjaftueshme për të përmbushur kriteret, për të qenë shfrytëzuese e pensionit me aftësi të kufizuara të plotë dhe të përhershme, siç përcaktohet me Ligjin 2004/131, me ç'rast e refuzon ankesën si të pabazuar dhe vërteton vendimin e shkallës së parë.

Nga Vendimet Qeverisë së Kosovës- MPMS- DAPRK të datave 05.03.2011, dt. 02.03.2011 u konstatua se paditësja më parë kishte gëzuar pensionin për shkak të aftësive të kufizuara ndërsa me Vendimin e datës 22.08.2017, i ishte mohuar kjo e drejtë, me konstatim se arsye e refuzimit të kërkesës është “ bazuar në vlerësimin e Komisionit mjekësor, i cili e ka vlerësuar aftësinë e kufizuar të ushtrueses së kërkesës, dhe ka ardhur në përfundim se te paditësi aftësia e kufizuar e plotë dhe e përhershme nuk ekziston”.

Në këtë kuptim, gjykata vlerëson se organi i padituri, nuk ka bërë fare arsyetim në vendimin e saj, se nga cila bazë paditëses i është rikthyer aftësia e plotë dhe e përhershme, kur nga vet vlerësimet e Komisioneve mjekësore të mëparshme është konstatuar se paditësjaka paaftësi tëplotë dhe të përhershme, andaj nuk është e qartë se si Komisioni mjekësor me datë 28.07.2017, ka ardhur deri në përfundim se gjendja e paditëses ka ndryshuar dhe se ajo nuk ka aftësi të përhershme respektivisht se ka pushuar se ekzistuar paaftësia e saj, dhe se ajo nuk i plotëson kushtet ligjore për t'iu njohur e drejta nëpension. Lidhur me këtë çështje nuk është dhënë asnjë arsyetim as nga Komisioni mjekësor e as nëvendimin e atakuar të së paditurës.

Gjykata si rregull konfliktin administrativ e vendos në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga vendimi i goditur me padi nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike.

Të metat e caktuara më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur që në ri-procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi ti mënjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë të bazuar në ligj.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, në kuptim të nenit 5,6, dhe 38 si dhe Nenit 46.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 64 të LKA-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE**  
**A.1713/2017 e dt. 16.10.2018**

Gjyqtarja

**KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi është e Anita Nikçi-Morina

Lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të Njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.